



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANË  
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT  
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik: “Auto Manoku Servis” shpk

**Adresa:** Tirane, Kashar, Yrshek, Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28.

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **Nr. REF-23583-10-09-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Blerje Goma dhe Bateri**

**Kohëzgjatja e kontratës:** Afati i lëvrimit të mallit do të jete 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Data 01.11.2024*

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *Buletini Nr.75 date 04 Nentor 2024*

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” shpk** NIPT-t: **L62311016C**

Vlera e ofertës: 1.725.000 (njëmilion e shtateqind e njezete e pesë mijë) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

**2. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” shpk** NIPT-t: **L12407012R**

Vlera e ofertës: 1.543.700 (njëmilion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

*Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

*Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor*

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**Operatori ekonomik “Besnik Meçi” shpk**

**NIPT-t: L12407012R**

Vlera e ofertës: 1.543.700(njëmilion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh

***për arsyet e mëposhtme***

- a) ***Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.9 përcaktohet sa më poshtë:***

**2.3.9** Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të depozitojë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, mostrat e artikujve si më poshtë:

1	Bateri: I=100Amp, U = 12 V	Copë	1
2	Bateri: I= 225 Amp, U = 12 V	Copë	1
3	Bateri: I=180 Amp, U = 12 V	Copë	1

Ne datën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave operatori ekonomik “**Besnik Meçi**” shpk nuk ka paraqitur mostrat duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar nga autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit Kriteret e Vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.9. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

- b) ***Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.9 përcaktohet sa më poshtë:***

**2.3.1.** Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 373.860 (treqind e shtatëdhjetë e tremijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi”, konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me objekt “F.V goma për automjetet e AKZM-se”. Operatori ekonomik ka paraqitur kontrate të ngjashme për gomat por nuk ka paraqitur dokumentacion provues për kontrata të ngjashme për bateri duke mos plotësuar Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1.

- c) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.4 përcaktohet sa më poshtë:*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizimi i prodhuesit nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne lidhje me kete kriter komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se per artikujt goma eshte paraqitur vertetimi nga distributori Varvara shpk por nuk eshte vërtetuar me dokumentacion provues lidhja e distributorit Varvara shpk me prodhuesit e deklaruar.

Gjithashtu per artikujt bateri eshte paraqitur vertetimi nga distributori “Auto pasion” shpk por gjithashtu nuk është vërtetuar me dokumentacion provues lidhja midis distributorit dhe prodhuesve te deklaruar.

Sa më siper operatori ekonomik nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4

- d) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.7 përcaktohet sa më poshtë:*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën **1 (një) ambjent për magazinimin e mallrave objekt prokurimi.**

Për sa me sipër operatori ekonomik te paraqes nje deklarate ku të përcaktojë vendndodhjen sipas formatit te mëposhtëm:

<b>Nr.</b>	<b>Vendodhja</b>	<b>Statusi</b>
1		Pronësi/qira

Për këtë, operatori/et ekonomik ofertues, duhet të paraqes/in dokumentacion që vërteton pronësinë / huapërdorjen / qiramarrjen si më poshtë:

***Dokumentacion që vërteton pronësinë:***

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; **ose**
- kontrata e shitblerjes; **ose**
- kontrata e dhurimit; **ose**
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

***Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:***

- Kontratë huapërdorje.

***Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:***

- Kontratë qiraje.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur vetem deklaratën ku deklaron se disponon ambiente me qera por nuk ka paraqitur dokumentacionin plotësues që dëshmon marrjen me qera të këtyre ambienteve sa me sipër kërkuar specifikisht në këto kritere. Nëse kjo operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.7

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...".

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik "Besnik Meçi" sh.p.k.nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**Auto Manoku Servis**” shpk me Adresa: Tirane, Kashar, Yrshek, Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28. se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.725.000** (njëmilion e shtateqind e njezete e pesë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga“Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **nuk është rasti** siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit,nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit,nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO X

Nëse Po ( Nr.\_\_ Datë\_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)